



UOGJ

Miresevini ne Universitetin Egerem Çabej

DEPARTAMENTI ADMINISTRIM PUBLIK

PERGJEGJESE E NJESISE BAZE / DEPARTAMENTIT

Një historik i shkurtër i Departamentit të Administrimit Publik

Përgatitja e ekonomistëve në Gjirokastrë e ka filluesën e saj në vitin 1968 kur në këtë qytet u çel filiali i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës. Dega e ekonomikut funksionoi për disa vite, duke i shërbyer kryesisht përgatitjes së ekonomistëve për rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Përmet e Tepelenë. Eksperienca e fituar, prania në rreth e specialistëve si dhe nevojat gjithnjë në rritje që diktonte ekonomia e tregut për ekonomistët bëri që në vitin 1996 të hapet pranë universitetit "Eqrem Çabej" dega "Kontabilitet financë" me VKM nr. 631 date 23.09.1996 "Një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 332 datë 13.05.1996 "Për pranimet në shkollat e larta në vitin shkollor 1996-1997".

Departamenti Ekonomik i çelur po në vitin 1996, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, fillimisht u ofronte studentëve programin 4-vjecar në Kontabilitet-Finance të cilët në fund të studimeve fitonin diplomë me titull "Kontabilist". Në vitin akademik 2001-2002 mbi bazën e shkresës së MASH Nr.2551 Prot., Datë 21.06.2001, me lëndë "Miratim për hapjen e kursit të studimit", u hap një degë e re me profil "Ekonomist për Administrim Publik".

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve nga hapja e këtij programi (2001 – 2016) Departamenti Ekonomik, sot Departamenti i Administrimit Publik është konsoliduar në programet



mësimore (curricula), në stafin akademik, si dhe ka diplomuar deri tani:

– 6 gjenerata studentësh në Administrim Publik (2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010) me programin 4 vjeçar dhe 6 gjenerata me programin Bachelor;

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9741, date 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH, i ndryshuar” programet 4 vjeçare janë ekuivalente me Master Shkencor sipas nenit 99/2, pika 3 e Ligjit nr.10307, dt.22.07.2010. Si pasojë e nevojave të tregut në rajonin e jugut por edhe më gjerë, deri më tani janë punësuar në masën mbi 83% e studentëve të diplomuar.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741, date 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH, i ndryshuar” filloi puna për reformimin e curriculave sipas Kartës së Bolonjës dhe ristrukturimin e Departamentit Ekonomik për të ofruar dy cikle studimi.

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Publik” është program që realizohet nga Departamenti i Administrimit Publik me përgjegjësinë drejtuese të tij dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera të Universitetit “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës. Ky program hartohet mbi bazën e Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe gjithë akteve normative që janë në fuqi.

Per çdo pyetje ju mund mund te kontaktoni ne adresat e e-mail-eve te personelit akademik te departamentit. Ju faleminderit.

Personeli akademik:

Titulli	kategoria	Adresa elektronike
1. Dr. Arjana Konomi	(Lektor)	akonomi@uogj.edu.al
2. Dr. Ilirjana Zyberi	(Lektor)	izyberi@uogj.edu.al
3. Dr. Arjola Mitaj	(Lektor)	amitaj@uogj.edu.al
4. MSc. Alma Kore	(As Lektor)	akore@uogj.edu.al
5. Msc. Bitila Zhuli	(As Lektor)	bzhuli@uogj.edu.al
6. Msc. Fatjon Malaj	(As Lektor)	fmalaj@uogj.edu.al
7. MSc. Arjan Gjini	(As Lektor)	agjini@uogj.edu.al

Personeli akademik:

Prof.Asoc Ermonela Ruspi	Profesor	I Ftuar
Msc Besnik Nuredini	As Lektor	Kohe e pjesshme
Msc Jorgji Mushka	As Lektor	Kohe e pjesshme
Msc Erlis Shalari	As Lektor	Kohe e pjesshme

Plani mesimor per programet e studimit te ciklit te pare

Plani mesimor Bachelor ne Administrim Publik

Ne sistemin Esse3:

Administrim Publik [BA]

Plani mesimor per programet e studimit te ciklit te dyte

Ju mund te informoheni me programet e studimit dhe gjithçka rreth tyre :

Ne sistemin Esse3: Administrim Publik [MP]

Plani mesimor Master Profesional ne Administrim Publik

Mund te informoheni me ndryshimet e fundit:

Vendim i Senatit per disa ndryshime ne Planin Mesimor MP ne Administrim Publik

Plani mesimor per programet e studimit me karakter profesional 2 vjecar



Ne sistemin Esse3:

Asistent Administrativ

Kerkimi Shkencor

Artikuj Shkencore Departamenti Administrim Publik

